

**VENDIM**  
**Nr. 917, datë 14.11.2015**

**PËR SHPALLJE DITË ZIE KOMBËTARE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 4, të ligjit nr. 8926, datë 22.7.2002, “Për formën dhe përmasat e flamurit kombëtar, përmbajtjen e himnit kombëtar, formën dhe përmasat e stemës së Republikës së Shqipërisë dhe mënyrën e përdorimit të tyre”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Shpalljen ditë zie kombëtare, ditën e hënë, datë 16.11.2015, në nderim të viktimave për shkak të akteve terroriste, të ndodhura mbrëmjen e datës 13 nëntor 2015, në Paris, Francë.

2. Në të gjitha institucionet shtetërore dhe publike të ulet flamuri kombëtar në gjysmështize dhe në orën 12:00 të mbahet një minutë heshtje.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTRI**

**Edi Rama**